

Gjykata supreme
e Republikës së Maqedonisë së Veriut
03Su.nr.710/20-2
11.12.2020

Me Vendim nr.44-9134/1 nga 03.11.2020 të botuar në Gazetën zyrtare të RMV nr.264/2020, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi pëlqim që Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut të realizojë zbatimin e procedurës për zgjedhje të personit juridik i cili kryen veprimtari ose posedon leje për grumbullimin dhe/ose transportimin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbeturinave të sendeve të tundshme – pajisjeve informatike të cilat janë të vjetra, që nuk përdoren dhe teknikisht të vjetruara.

Për këtë qëllim Ju bëjmë Thirrje personave të interesuar juridik, që deri në datën 21.12.2020 të dorëzojnë ofertë për marrjen e mbeturinave elektronike – pajisjeve informatike që nuk përdoren të theksuara në Listën e sendeve të tundshme në bashkëngjitje.

Pas skadimit të afatit për parashtrimin e ofertave, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të bëjë zgjedhjen e ofertës më të volitshme edhe atë në bazë të kriterëve në vijim;

- Periudha kohore e marrjes së mbeturinës – 45 pikë dhe
- Çmimi me të cilin do të merret mbeturina - 55 pikë

Oferta duhet të përfshijë informacionet:

- Për periudhën kohore në të cilën mbeturina e sipërpërmendur do të merret nga Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- Çmimi me të cilin mbeturina do të merret

Personat e interesuar juridik, së bashku me ofertën duhet të dorëzojnë:

- Leje për deponim dhe trajtim të mbeturinave elektrike dhe elektronike
- Leje për grumbullim dhe transport të mbeturinave

Ofertat, së bashku me dokumentacionin e kompletuar të dorëzohen me postë elektronike në e-mail info@vsrm.mk ose përmes postës në adresën e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, bul. "Krste Misirkov" nr.8 – 1000 Shkup, me shenjë për Komision të sendeve të tundshme dhe të patundshme, deri në datën 21.12.2020.

Shtojcë: Lista e sendeve të tundshme

Komisioni i sendeve të tundshme dhe të patundshme